



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Këshilli Gjyqësor i Kosovës - Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR

RAPORTI VJETOR 2018



TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| • HYRJE..... | 6 |
| • ZYRA E DREJTORIT TË SEKRETARIATIT TË KGJK | 8 |
| • DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME..... | 9 |
| • DEPARTAMENTI LIGJOR | 14 |
| • DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA | 19 |
| • DEPARTAMENTI I STATISTIKËS | 25 |
| • DEPARTAMENTI I LOGJISTIKËS | 26 |
| • DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM | 31 |
| • ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE KOMUNIKIM | 34 |
| • ZYRA E PROKURIMIT | 36 |
| • ZYRA PËR EVIDENCË PENALE | 39 |
| • INTEGRIMI EVROPIAN | 42 |
| • ZYRA E PËRKTHIMEVE..... | 44 |
| • KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN | 45 |
| • ÇERTIFIKUESI..... | 47 |

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|---------|--|
| KGJK | Këshilli Gjyqësor i Kosovës |
| SKGJK | Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës |
| K D | Komisioni Disiplinor |
| ZPD | Zyra e Prokurorit Disiplinor |
| NJSHPGJ | Njësia e Shqyrtimit të Performancës Gjyqësore |
| GJS | Gjykata Supreme |
| GJA | Gjykata e Apelit |
| GJTH | Gjykata Themelore |
| DAP | Departamenti i Administratës Përgjithshme |
| TIK | Teknologji Informative dhe Komunikim |
| ZQEP | Zyra Qendrore e Evidencës Penale |
| KE | Komisioni Evropian |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| PFSD | Programi i Fuqizimit të sistemit të drejtësisë |
| MEF | Ministria e Ekonomisë dhe Financave |



HYRJE

Informacion i përgjithshëm për administratën e sistemit gjyqësor

Administrata e sistemit gjyqësor përfshin të gjithë stafin administrativ që punojnë në kuadër të institucionit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sistemin gjyqësor përfshire edhe stafin e administratës së Sekretariatit të KGJK, ZPD dhe NJSHPGJ, ju njoftojmë se numri i përgjithshëm të punësuarve në sistemin gjyqësorë - SKGJK, NJSHPGJ, ZPD është 1602, nga të cilët shërbyes civil janë 1140 dhe jo - shërbyes civil janë 462.

Sekretariati është organ administrativ profesional i themeluar me Ligj për Këshillin Gjyqësor të Kosovës i cili në kuadër të tij ka strukturën e vet organizative të përcaktuar sipas Rregullores Nr.12/2015 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, me qëllim të ofrimit të mbështetjes profesionale dhe administrative Këshillit dhe gjykatave.

Sekretariati udhëhiqet nga Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së, derisa shërbimet përkatëse udhëhiqen nga menaxherët, kurse njësitet e specializuara udhëhiqen nga koordinatorët, respektivisht shefat e zyrave.

Sekretariati i KGJK ndihmon profesionalisht punën e KGJK-së duke hartuar rekomandime për mbarëvajtjen e punës së gjykatave dhe jep mendime të ndryshme të paanshme, profesionale nga fusha ligjore, administrative dhe strategjike që i kërkohen nga fushë veprimtaria e vet. Zbaton të gjitha rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit, lidhur me kryerjen e punëve administrative dhe profesionale. Mbikëqyrë punën administrative të gjykatave dhe është kompetent për rregullimin e të gjitha veprimtarive sipas legjislacionit në fuqi dhe i raporton Këshillit.

Kurdoherë që sekretariati vlerëson se ka nevojë për aktet e reja për ndryshime në aspektin e administrimit efektiv dhe efikas të administratës gjyqësore dhe të vetë Sekretariatit, varësisht nga fushë veprimtaria i rregullon vetë ose i propozon akte juridike Këshillit për miratim. Përgatitë dhe propozon plane të ndryshme strategjike dhe pas aprovimit nga ana e Këshillit monitoron zbatimin e tyre. Bashkëpunon me institucione të ndryshme përkatëse si vendore dhe ndërkombëtare dhe mbledhë informata të ndryshme për avancimin e punës së administratës së Sekretariatit dhe administratës gjyqësore.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës përbëhet nga nëpunësit civil të cilët përbëjnë administratën qendrore të sistemit gjyqësor të Kosovës, dhe është i ndërtuar mbi bazën e dy shtyllave: Shërbimi i Administratës së Përgjithshme dhe Shërbimi për Çështje Ligjore dhe Zhvillim të Politikave.

Struktura organizative e Sekretariatit

Sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr.12/2015, për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, struktura organizative e Sekretariatit është si në vijim:

- **Zyra e Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së**
 - Departamenti i Administratës Qendrore
 - Departamenti Ligjor
 - Departamenti për Buxhet e Financa
 - Departamenti për Teknologji Informative dhe Komunikim
 - Departamenti i Auditimit të Brendshëm
 - Departamenti Logjistikës
 - Departamenti i Statistikës
 - Zyra e Prokurimit
 - Zyra për Përkthim dhe Mbështetjen
 - Zyra për Evidencë Penale
 - Integrimet evropiane
 - Komunikimi me publikun
 - Certifikuesi

Gjatë vitit 2018, të punësuar në Sekretariat kanë qenë shtatëdhjetë e një (71) staf administrativ.

ZYRA E DREJTORIT TË SEKRETARIATIT TË KGJK

Funksionet dhe përgjegjësitë

Drejtori i Sekretariatit udhëheq dhe përfaqëson Sekretariatit dhe është udhëheqësi më i lartë administrativ në sistemin gjyqësor. Drejtori është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe vendimeve të KGJK-së dhe vepron si autoritet ndërlidhës mes KGJK-së dhe entiteteve të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare, menaxhimin dhe funksionimin normal dhe efektiv të sekretariatit dhe administrimin e gjykatave, planifikimin e resurseve humane të Sekretariatit dhe gjykatave duke bërë shpërndarjen e pozitive në përputhje me nevojat reale duke u bazuar në informatat të punuara nga shërbimi i administratës së përgjithshme. Drejtori i raporton drejtpërdrejt Kryesuesit të Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion.

Në kuadër të Zyrës së Drejtorit, ushtrohen edhe përgjegjësi tjera, përmes zyrtarëve të caktuar, nga fusha e integriteteve evropiane, komunikim publik, certifikimi i pagesave, dhe çështje tjera nga fushë veprimtaria e Drejtorit të Sekretariatit të KGJK-së.

Me qëllim të avancimit të shërbimeve Drejtori i Sekretariatit ka mbajtur takime të rregullta me udhëheqësit e departamenteve dhe zyrave. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar çështje që kanë qenë me rëndësi për arritjen e qëllimeve të administratës së sistemit gjyqësorë si dhe është mbështetja administrative për gjykatat. Gjatë kësaj periudhe raportuese, gjithashtu ai ka mbajtur takime në nivel më të gjerë duke përfshirë administratorët e gjykatave.

Drejtori ka mbajtur kontakte të rregullta me partnerët vendor dhe ndërkombëtarë si dhe me donatorë me qëllim të kontributit të përbashkët për interesin më të mirë për publikun dhe sistemin gjyqësor.



DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Njësia për Administratë dhe Personel (Departamenti i Administratës së Përgjithshme) sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr.12/2015, për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të Departamentit të Administratës së Përgjithshme, aktualisht punojnë shtatë (7) punëtorë staf administrativ.

Ky departament gjatë vitit 2018 ka realizuar aktivitetet si në vijim:

Pozitat e aprovuara

Me Ligjin mbi Buxhetin e vitit 2018 për vijën buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë lejuar gjithsejtë : **2271 pozita**, si në vijim:

- Për gjyqtar janë lejuar **452 pozita** (Nga këto pozita 20 pozita janë për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme dhe 48 pozita për implementimin e Marrëveshjes së Brukselit për Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe gjykata tjera).
- Për staf administrativ në Gjykata, Sekretariat dhe njësitë e Këshillit janë lejuar **1819 pozita**. (Prej këtyre 115 pozita janë për implementimin e Marrëveshjes së Brukselit për Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe gjykatat tjera).

Në kuadër të KGJK kemi këto programe buxhetore

- Programi buxhetor i Sekretariatit të KGJK, 106 pozita (prej tyre dy (2) pozita janë të rezervuara për Kryesues dhe Zëvendës/Kryesues dhe dy (2) pozita për përfitimin e dy (2) ish zyrtar të lartë (Ish kryetarët e Gjykatës Supreme) nga radhët e pozitave të gjyqtareve;
- Programi buxhetor i Gjykatës Supreme me Dhomën e Veçantë - 103 pozita (prej tyre 39 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës së Apelit -158 pozita (prej tyre 52 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Prishtinë - 507 pozita (prej tyre 107 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Prizren -230 pozita (prej tyre 46 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Pejë - 234 pozita (prej tyre 41 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Mitrovicë - 346 pozita (prej tyre 64 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Gjilan - 219 pozita (prej tyre 39 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Ferizaj - 176 pozita (prej tyre 32 pozita për gjyqtar);
- Programi buxhetor i Gjykatës Themelore Gjakovë - 162 pozita (prej tyre 28 pozita për gjyqtar);

- Programi buxhetori i Zyrës së Pro. Disiplinor (ZPD) - 23 pozita;
- Programi buxhetori i Njësisë për Sh. e Për. së Gj. – 7 pozita.

Numri pozitivave në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017 është rritur për 112 pozita vetëm për staf administrativ. Pra, numri i pozitave për gjyqtar ka ngelur i njëjtë në raport me vitin 2017, kurse është rritur për staf administrativ.

Sipas strukturës organizative aktuale të aprovuar nga ana e Këshillit për Programin buxhetor të SKGJK janë të aprovuara 106 pozita, prej tyre janë të plotësuara 71, për programin buxhetor të ZPD janë të aprovuara 23 pozita, prej tyre të plotësuara 22 pozita dhe në NJSHPGJ janë të lejuara 7 pozita dhe të plotësuara. Si pikënisje është muaji dhjetor i vitit 2018. Deri në momentin e raportimit pozita të lira janë 36 pozita.

Procesi i rekrutimit i këtyre pozitave do të filloi pas aprovimit të strukturës së re organizative të Sekretariatit, njësisë së Këshillit dhe gjykatave komfor Ligjit nr. 06/L-055, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, Ligjit Nr.06/057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Katalogut të Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Me aprovimin e këtyre strukturave do të filloi procesi i rekrutimit i të gjitha pozitave të lira dhe do të lëshohen akt emërimet në përputhje me emërtimet e pozitave, siç parashihen në struktura.

Rekrutimet

Në SKGJK, gjatë këtij viti janë bërë rekrutime për këto pozita:

Me konkurs të jashtëm:

- Zyrtar për përkthime dy (2) pozita në SKGJK;
- Zyrtar administrativ në zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm;
- Praktikant (me pagesë) sipas marrëveshjes dhe mbështetjes financiare nga Agjencioni Gjerman për Bashkëpunim dhe Zhvillim (GIZ).

Me konkurs të brendshëm:

- Zyrtar i lartë ligjor tre (3) pozita;
- Zyrtar ligjor një (1) pozitë;
- Zyrtar i lartë për evidencë penale një (1) pozitë;
- Udhëheqës i Divizionit për Evidencë penale;
- Administrator i lartë i data bazës një (1) pozitë.

Në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD) janë bërë rekrutime për këto pozita:

Me konkurs të jashtëm:

- Zyrtar ligjor tre (3) pozita.

Me konkurs të brendshëm:

- Drejtori i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme.

Në Njësinë për Shqyrtimin e Performansë së Gjyqësorit është bërë rekrutim për këtë pozitë:

Me konkurs të brendshëm:

- Zyrtar i lartë shqyrtues dy (2) pozita.

Transferim

Në Zyrën e Teknologjisë Informative në SKGJK është bërë një transferim nga zyrtari i teknologjisë informative në administrator i data bazës me koeficient të njëjtë.

Dorëheqje vullnetare nga puna

Në SKGJK gjatë vitit 2018, kemi dy dorëheqje vullnetare nga puna të dy zyrtarëve për përkthime.

Kontratat në vepër


Gjatë vitit të 2018, kemi rekrutuar vetëm një (1) punëtor me kontratë në vepër , dhe atë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.

Listat e pagave

Si zakonisht në fund dhe fillim të çdo muaji është punuar dhe punohet rreth listës së pagave . Kështu, çdo ndryshim që është bërë për shkak të pranimeve të reja në punë, heqja dorë vullnetare nga puna, largimet nga puna, avancimet , transferim, pushimet pa pagesë, pushimet mjekësore më shumë se 20 ditë brenda vitit, etj., janë inkorporuar në listën e pagave, në dosjen elektronike dhe në dosjen e shkruar personale.

Në vazhdimësi kemi bërë pagesën për Shpërblimin e përvjetorit (Jubile) të nëpunësve civil që janë në marrëdhënie të vazhdueshme punë në Shërbimin Civil në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vitesh punë.

Gjatë vitit 2018, për periudhën janar – shtator, përjashtuar gjyqtarët kemi bërë kompensimin e shtesës pre 50 euro sipas vendimit të Qeverisë, kurse për periudhën tetor – dhjetor, edhe pse u janë dërguar listat Ministrisë së Financave përkatësisht divizionit të pagave në Departamentit e Thesarit, nuk është bërë kompensimi me arsyetim të mungesës së mjeteve financiare.



Shërbyesit civil në kuadër të Këshillit në vazhdimësi i realizojnë kompensimet për shtesat në pagë dhe kompensimet e tjera sipas Ligjit Nr.03/L-147, Për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr.33/2012, Për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet të tjera të Nëpunësve Civil dhe Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor Nr.2014/02.

Vlerësimet e punës

Formularët mbi vlerësimin e punës për vitin 2018 të gjithë nëpunësve civil të cilave ju janë ofruar janë sistemuar në dosjen personale të çdo nëpunësi. Nuk kemi pasur ndonjë vlerësim të dobët për nëpunësit civil për inicim procedurë për shkak të moskryerjes së detyrave të punës në mënyrë të kënaqshme.

Akt Emërimet

Të gjithë akt emërimet e nëpunësve civil, për pozitat të cilat për nga natyra, funksionimi dhe detyrat janë pozita të përhershme të punës janë lëshuar me kohë të pacaktuar.

Komisionet Disiplinore

Gjatë vitit 2018, nuk kemi pasur ndonjë inicim të procedurës disiplinore për asnjë të punësuar, po ashtu nuk ka pasur as ndonjë vërejtje të shqiptuar gojore, apo me shkrim.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave

Në këtë komision janë kaluar pesë (5) raste për shqyrtim.

Pushimet

Në pajtim me Rregulloren, Nr.06/2011, Për Pushimet e Nëpunësve Civil, i janë lëshuar vendimet mbi pushimet vjetore, mbi pushimet e jashtëzakonshme pa pagesë, mjekësore, prindore dhe të përdëllimit.

Dosjet


Dosjet si të gjyqtarëve dhe stafit tjetër, përpos që mbahen në mënyrë fizike mbahen edhe në mënyrë elektronike. Ato përditësohen me dokumentet e ofruara dhe mbi bazën e evidencës, sipas kërkesave si të gjyqtarëve dhe stafit administrativ të SKGJK, ZPD dhe NJSHPGJ lëshohen vërtetime mbi përvojën e punës vendime mbi përfundimin e marrëdhënies së punës, etj.

Për çdo tre muaj kemi dërguar raportin i cili kërkohet nga Ministria e Administratës Publike, lidhur me numrin e të punësuarve, strukturën kualifikuese, gjinore dhe etnike e Shërbyesve Civil në Sekretariat, dhe njësitë e Këshillit.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil (KPMSHC), ka bërë auditim në punën e kësaj Njesisë dhe ka dhënë rekomandimet mbi të gjeturat nga mostrat e rishikuara.

Nga mostrat e rishikuara nuk kanë gjetur ndonjë parregulsi në menaxhimin e pagave dhe mëditjeve. Kanë dhënë disa rekomandime të arsyeshme në fusha tjera e që janë në proces të zbatimit për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna.

Çdo shkresë që është adresuar në adresë të kësaj Njesisë brenda afatit ligjor, ne i kemi dhënë përgjigjen e duhur, apo e kemi adresuar tek organi kompetent.



DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas mandatit të përcaktuar në rregulloren Nr.12/2015 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit dhe është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të Departamentit Ligjor aktualisht punojnë gjashtë (6) staf administrativ. Ky departament gjatë vitit 2018 ka realizuar aktivitetet si në vijim:

Hartimi i akteve Juridike

- Hartimi i Rregullores (Nr. 01/2018) për Sistemin Qendror të Evidencës Penale të Kosovës;
- Hartimi i Rregullores Nr.02/2018 për Shfrytëzimin e Teknologjisë Informative të Komunikimit në Sistemin Gjyqësor;
- Hartimi i Planit të Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2018.

Përfaqësimet e Këshillit Gjyqësor në Gjykatat e Kosovës

Është përgatitur i gjithë materialin i nevojshëm lidhur me njëqind e gjashtëdhjetë e katër (164) përfaqësimet në seancat gjyqësore në të cilën Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka qenë në cilësinë e palës së paditur ose palë paditëse.

Janë hartuar gjashtëdhjetë e dy (62) përgjigjeje në padi, ku Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka qenë në cilësinë e palës së paditur ose palë paditëse, tetë (8) ankesa të ushtruara ndaj vendimeve të shkallës së parë, ku KGJK ka qenë në cilësinë e palës së paditur dhe gjashtë (6) prapësime të lëshuara nga Përmbauesit Privat, ku KGJK ka qenë palë e paditur.

Hartimi i vendimeve

Gjatë këtij viti, Departamenti Ligjor ka hartuar dyqind e pesëdhjetë e gjashtë (256) vendime të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Angazhimet rreth Komisionit Disiplinor Gjyqësor

Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në vitin 2018 ka pranuar dy (2) raporte përfundimtar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, dy (2) raporte përfundimtare janë bartur nga viti 2018. Komisioni ka mbajtur tre (3) seanca dëgjimore, në të cilën ka shqyrtuar gjithsej, katër (4) raporte përfundimtare.

Me rastin e shqyrtimit të këtyre raporteve, në seancën e cekur me lartë, janë marrë gjithsej katër (4) vendime, dhe janë shqiptuar këto masa:

- Ulje e pagës për gjashtë (6) muaj, 50% nga paga mujore dy (2) vendime;
- Ulje e pagës për tre (3) muaj, 20% nga paga mujore një (1) vendim;
- Lirim nga përgjegjësia disiplinore një (1) vendim.

Kundër këtyre vendimeve palët kanë ushtruar ankesë. KGJK pasi i ka shqyrtuar ankesën e ka refuzuar si të pa bazuar.

Angazhimet rreth Komisionit për Administrimin e Gjykatave

Gjatë periudhës raportuese, KAGJ ka mbajtur nëntë (9) takime pune dhe ka trajtuar me profesionalizëm dhe përkushtim nevojën e unifikimit të praktikës së administratës në të gjitha gjykatat e Kosovës.

Janë ndërmarr të gjitha veprimet për përgatitjen e takimeve të KAGJ, hartimi i drafteve fillestare të cilat i janë paraqitur për shqyrtim KAGJ-it, procesverbalet si dhe draftet finale.

Në kuadër të kompetencave të veta Komisioni për Administrimin e Gjykatave ka nxjerrë dhe i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim:

- ❖ Memorandum shpjegues për formën e raportit për mbylljen e lëndëve kundërvajtës të cilat kanë arritur afatin e parashkrimit, por janë pjesë në inventarin e lëndëve në pritje, bazuar në vendimin KGJK, nr.358/2017, datë 13 Dhjetor 2017;
- ❖ Raport gjithëpërfshirës lidhur me zbatimin e vendimit KGJK.nr.358/2017, datë 13 Dhjetor 2017 - Mbyllja e lëndëve kundërvajtës të cilat kanë arritur afatin e parashkrimit por janë pjesë në inventarin e lëndëve në pritje (lëndë të hapura);
- ❖ Memorandum shpjegues për listën e afateve të ruajtjes së lëndëve/ regjistrave të gjyqësorit të Kosovës dhe ndërmarrja e veprimeve të nevojshme;
- ❖ Memorandum shpjegues për refuzimin e kërkesës për themelimin e degës së Gjykatës Themelore në Komunën e Hanit të Elezit;
- ❖ Memorandum shpjegues për standardizimin e formatit të raporteve të kryetarëve të Gjykatave;

- ❖ Rekomandim adresuar gjykatave për ndërprerjen e praktikave për mbulimin e shpenzimeve nga palët me rastin e përdorimit të automjeteve zyrtare për nevojat e këqyrjes në vend, deri në një Vendim tjetër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- ❖ Memorandum shpjegues për unifikimin e praktikave mbi përdorimin e automjeteve zyrtare për nevojat e këqyrjes në vend dhe mbulimin e shpenzimeve;
- ❖ Memorandum shpjegues, përfshirja e gjashtë (6) pozitive në kuadër të Organogramit të Gjykatës së Apelit dhe shtatë (7) pozitive në atë të Dhomës së Posaçëm të Gjykatës Supreme;
- ❖ Memorandum shpjegues lidhur me kërkesën e drejtorit të ZPD-së për vlerësimin e ligjshmërisë së Urdhrit të datë 08 gusht 2018, i nxjerrë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren.

Komisioni për Administrimin e Gjykatave ka nxjerr pesë (5) kërkesa, vërejtje dhe sugjerime drejtuar kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës lidhur me rekomandimet që janë përgatitur për KGJK. Ky Komision në vazhdimësi e ka mbështetur grupin punues për hartimin e draft-Rregullores për Arkivin Qendror të Gjyqësorit të Kosovës.

Angazhimet rreth Komisionin për Kompensimin e dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye

Komisionin për Kompensimin e dëmit për personat e dënuar, ose arrestuar pa arsye, gjatë vitit 2018, ka shqyrtuar dhe kompensuar 185 raste, në shumën prej 463.353.24, ndërsa, ka shqyrtuar, por ende kanë mbetur pa u kompensuar edhe 28 raste këto të shqyrtuara gjatë muajit dhjetor 2018.

Angazhimet rreth Komisionin për Çështje Normative

Komisionit për Çështje Normative, gjatë vitit 2018, ka mbajtur pesë (5) takime në të cilën janë shqyrtuar, Plani i Punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2018 dhe të gjitha rregulloret të miratuara nga KGJK- gjatë këtij viti.

Komente dhe mendime Juridike

- Përgjigje komente lidhur me rastin, KI 108/18 për Gjykatën Kushtetuese;
- Përgatitja rekomandimit në lidhje me kompensimin shtesë të anëtareve të KGJK-së për punën shtesë në Këshill dhe Komisione sipas vendimit KGJK, Nr. 368/2017 të datës 27 dhjetor 2018, pas zbatimit të vendimit të Qeverisë, nr. 04/20 dhjetor 2018;
- Përgatitja e rekomandimit në lidhje me Zgjedhjen e Komisionit për Kompensimin e Demit për Personat e Dënuar, ose të Arrestuar pa Arsye;
- Përgatitja e rekomandimit në lidhje me kompensimin e gjyqtareve që kanë dalë në pension, apo janë larguar nga gjyqësori pas zbatimit të vendimit, Nr. 04/20 të datës, 20 dhjetor 2018;
- Përgatitja e Raportit Informues, mbi sistemin e përmbartimit të vendimeve gjyqësore në Republikën e Kosovës;
- Përgatitja e Raportit Drejtësia dhe punët e brendshme për MSA;
- Dhënia e 122 komenteve në lidhje me rekomandimet e Projektit të Binjakëzimit të BE-së "Fuqizimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë;
- Përgatitja për KGJK e komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nga gjykatat dhe komenteve të dhëna në emër të Departamenti Ligjor në tre (3) projektligjet e pakos së gjyqësorit, si dhe përgatitja në formë përfundimtare e këtyre komenteve për Ministrinë e Drejtësisë dhe Kuvendin e Kosovës;
- Dhënia e komenteve rreth Memorandumit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kosovo-American Consulting-Company;
- Dhënia e komenteve rreth Memorandumit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Rrjetit të Grave të Kosovës;
- Dhënia e komenteve rreth Memorandumit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Organizatës për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet "ÇOHU;
- Dhënia e komenteve rreth Memorandumit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Organizatës Mbrojtë të Drejtat Tua;
- Dhënia e komenteve rreth Memorandumit të Mirëkuptimit për Financimin e Projekteve nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (Qeveria) e përfaqësuar nga Zyra e Jashtme dhe Komonuelthit (FCO) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Republika e Kosovës;
- Dhënia e komenteve rreth Memorandumit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Shoqata e Gruas "Jeta";
- Pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e draft-Rregullores për Arkivin Qendror të Gjyqësorit të Kosovës;

- Pjesëmarrje në grupin punues për shqyrtimin e projekt-Ligjit për Ndërmjetësim;
- Pjesëmarrje në grupin punues për krijim e ueb faqes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave;
- Pjesëmarrje në punëtoritë e organizuara nga Projekti i Binjakëzimit "Fuqizimi i Efikasitetit, Llogaridhënies dhe Transparencës së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë";
- Pjesëmarrje në takime pune me përfaqësuesit e Programit JSSP-USAID, që në vazhdimësi ka mbështetur Komisionin për Administrimin e Gjykatave dhe Grupin Punues për hartimin e draft-Rregullores së Arkivit Qendror Gjyqësor dhe Gjykatave.

Përgjigje në shkresat e Qytetareve

Ky Departament ka pranuar gjithsej, dyqind e një (295) shkresa-parashtresa nga qytetar, avokat, institucione dhe OJQ të ndryshme drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilët kanë pas të bëjnë kryesisht rreth çështjes së procedurave ligjore, pretendimeve për sjellje të pahijshme ndaj gjyqtareve etj.



DEPARTAMENTI PËR BUXHET DHE FINANCA

Duke u nisur nga baza ligjore e Menaxhimit të Buxhetit dhe Financave Publike e cila është në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Ligjin vjetor të Buxhetit, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjit për Gjykata pastaj në Qarkoret Buxhetore, Rregulloret, Udhëzimet nga Departamenti i Thesarit dhe i Buxhetit në MF si dhe në Rregulloret, Udhëzimet dhe Vendimet e brendshme të KGjK/SKGjK-së si dhe sipas mandatit të përcaktuar në rregulloren Nr.12/2015 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, Departamenti për Buxhet dhe Financa është nën mbikëqyrjen e drejtorit të Sekretariatit të KGjK-së, në të cilin janë të punësuar gjithsej gjashtë (6) zyrtarë sipas planit të punës dhe objektivave të përcaktuara paraprakisht, gjatë vitit 2018 ka kryer këto punë të prezantuara shkurtimisht si në vijim:

- Është bërë ekzekutimi i buxhetit të KGjK-së sipas ndarjeve buxhetore në Ligjin Nr. 06/L-020 për “Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018” si dhe sipas ndryshimeve të ndodhura gjatë vitit;
- Në bashkëpunim me Departamentet tjera të SKGjK-së është bërë përgaditja e KASH-it 2019-2021 sipas Instruksionit për përgaditjen e KASH-it nga MF si dhe është bërë planifikimi i buxhetit 2019 sipas qarkoreve buxhetore 2019/01 dhe 2019/02 në bashkëpunim edhe me gjykatat ku pastaj kërkesa buxhetore me rekomandim të komisionit për buxhet,financa dhe personel është aprovuar nga Këshilli dhe i është dërgu MF dhe Kuvendit;
- Janë regjistruar të gjitha transaksionet në regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit (SIMFK) si dhe është mbajtur evidenca kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik në Sekretariatit e KGjK-së;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare të buxhetit dhe të hyrave si dhe shpërndarja e këtyre raporteve njësisive të KGjK-s dhe SKGjK;
- Përgatitja e raporteve mujore për obligimet e papaguara dhe dërgimi i raporteve në Ministrin e Financave;
- Përgatitja e raporteve për barazimin tremujor të hyrave dhe shpenzimeve si dhe dërgimi i raporteve në Ministrin e Financave;
- Janë përgadit pasqyrat vjetore financiare të KGjK-së dhe gjykatave sipas Rregullores së MF-Nr.03/2013 për “Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore” dhe udhëzimeve nga departamenti i Thesarit në MF;
- Është funksionalizuar softwerit “E-pasuria” pas modifikimit (rregullimit) nga Ministria e Administratës Publike për të ja përshtatur gjykatave në bazë të Udhëzimit Administrativ 01/2015 “Në zbatim të vendimit të KGjK-së për delegim të Përgjegjësive në çështje të personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës”.

- Janë regjistruara Pasuritë Jo Financiare Kapitale (1,000.00 €, apo më shumë) në SIMFK (Ministria e Financave) si dhe është bërë azhurnimi i “Regjistrit të Pasurive jo Financiare Kapitale“ në këtë sistem, janë regjistruar Pasuritë Jo Financiare, Jo Kapitale (më pak se 1,000.00 €) në programin “e-pasuria”(Ministria e Administratës Publike) si dhe është bërë azhurnimi i “Regjistrit të Pasurisë Jo Financiare, Jo Kapitale” në këtë program. Programi “e-pasuri” nga MAP është bërë i qasshëm për përdorim nga të gjitha Gjykatat e Kosovës;
- Janë mbajtur trajnime për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve financiar në KGjK-së dhe gjykatave që kanë të bëjnë me zbatimin e rregulloreve, udhëzimeve dhe qarkoreve nga Ministria e Financave dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ku objektiv dhe qëllim i trajnimeve përveq ngritjes së aftësive profesionale ka qenë edhe sqarimi dhe zgjerimi i aftësive të zyrtarëve financiar në gjykata lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 01/2015 “Në zbatim të vendimit të KGjK-së për delegim të Përgjegjësive në çështje të personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës” dhe funksionalizimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësive që dalin nga ky udhëzim.

BUXHETI, TË HYRAT DHE SHPENZIMET 2018

Buxheti i përgjithshëm i Këshillit Gjyqësor të Kosovës si organizatë buxhetore dhe dymbëdhjetë (12) programet e tij: Sekretariati i KGjK, Zyra e Prokurorit Disiplinor, Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore, Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, Gjykata Themelore Prishtinë, Gjykata Themelore Prizren, Gjykata Themelore Gjilan, Gjykata Themelore Ferizaj, Gjykata Themelore Pejë, Gjykata Themelore Gjakovë, Gjykata Themelore Mitrovicë për vitin 2018 sipas Ligjit fillestar të buxhetit Nr.06/L-020, ka qenë 23,495,024.00€ për gjithsej: 2,271 pozita, prej tyre 452 gjyqtar dhe 1,819 pozita administrative.

Në vitin 2018 nuk ka pasur rishikim të buxhetit mirëpo kanë ndodhur ndryshime të buxhetit gjatë vitit si rezultat i zbatimit të vendimeve të qeverisë, përkatësisht vendimit nr.04/20 për ndryshimin e pagave për Qeverinë në bazë të cilit janë ngritur edhe pagat e gjyqtarëve dhe sipas vendimit nr.18/60 të datës 07.08.2018 janë ndarë shtesat prej 50 € në muaj për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive si dhe me rastin e kursimeve dhe shkurtimeve sipas vendimeve të ndryshme të Qeverisë, buxheti përfundimtar (final) i KGjK-së, për vitin 2018 në SIMFK me të hyrat dhe donacionet është 29,025,053.83 €.

Të hyrat gjyqësore të gjeneruara nga Këshilli, përkatësisht nga Gjykatat, Sekretariati i KGjK dhe Dhoma e Posaçme në vitin 2018 janë gjithsej: 7,933,154.59 €. Plani i realizimit të të hyrave është 100.41 % në krahasim me planifikimin për vitin 2018 (7,900.000.00 €).

| BUXHETI DHE SHPENZIMET E KGJK-së 2018 | | | | | | | |
|--|-------------------------------|---------------------------|-------------------------|---------------------------|----------------------------|------------------------------|--|
| Kategoritë ekonomike | Buxheti fillestar 2018 | Buxheti Final 2018 | Buxheti i zotuar | Buxheti i zotuar % | Buxheti i shpenzuar | Buxheti i shpenzuar % | |
| Paga dhe mëditje | 17,731,599.00 | 23,494,896.28 | 22,476,228.67 | 95.66 | 22,476,228.67 | 95.66 | |
| Mallra dhe shërbime | 4,068,425.00 | 4,076,425.00 | 3,942,149.67 | 96.71 | 3,817,015.35 | 93.64 | |
| Shpenzime komunale | 450,000.00 | 385,297.63 | 360,996.62 | 93.69 | 358,587.71 | 93.07 | |
| Subvencione dhe transfere | 350,000.00 | 464,453.00 | 464,433.24 | 100.00 | 463,353.24 | 99.76 | |
| Shpenzime kapitale | 895,000.00 | 510,000.00 | 510,000.00 | 100.00 | 495,130.13 | 97.08 | |
| Donacione | | 93,981.92 | 83,276.19 | 88.61 | 83,276.19 | 88.61 | |
| Totali | 23,495,024.00 | 29,025,053.83 | 27,837,084.39 | 95.91 | 27,693,591.29 | 95.41 | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme buxheti i përgjithshëm i KGJK, 29,025,053.83 € në vitin 2018 është zotuar në shumën prej 27,837,084.39 €, shprehur në përqindje 95.91 % ndërsa është shpenzuar 27,693,591.29 €, shprehur në përqindje 95.41 %.

Sipas kategorive ekonomike buxheti përgjithshëm i KGJK është zotuar dhe shpenzuar si në vijim:

- Paga dhe Mëditje: Nga shuma vjetore e buxhetit prej 23,494,896.28 €, janë zotuar dhe shpenzuar 22,476,228.67 €, shprehur në përqindje 95.66 %;
- Mallra dhe Shërbime: Nga shuma vjetore e buxhetit prej 4,076,425.00 €, janë zotuar 3,942,149.67 € shprehur në përqindje 96.71 %, ndërsa janë shpenzuar 3,817,015.35 €, shprehur në përqindje 93.64 %;
- Shpenzimet Komunale: Nga shuma vjetore e buxhetit prej 385,297.63 €, janë zotuar 360,996.62 € shprehur në përqindje 93.69 %, ndërsa janë shpenzuar 358,587.71€, shprehur në përqindje 93.07 %;

- Subvencione dhe transfere: Nga shuma vjetore e buxhetit nga kjo kategori për transfere prej 464,453.00 € janë zotuar dhe shpenzuar 464,433.24 €, shprehur në përqindje 100 %, ndërsa janë shpenzuar 463,353.24 €, shprehur në përqindje 99.76 %;
- Shpenzimet Kapitale: Nga shuma vjetore e buxhetit 510,000.00 € janë zotuar 510,000.00 € shprehur në përqindje 100 %, ndërsa janë shpenzuar 495,130.13 €, shprehur në përqindje 97.08 %;

Sqarim: Në donacione shuma e përgjithshme prej 93,981.92 € janë nga UNDP (50,237.60 €) dhe GIZ (43,215.00€) kryesisht për mbështetje të stafit administrativ në disa gjykata të Kosovës (Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit, GjTh Prishtinë, GjTh Mitrovicë dhe SKGJK), ndërsa shuma 529.32 € e cila figuron në SIMFK është e bartur nga vitet paraprake.

| BUXHETI DHE SHPENZIMETSIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE TË KGJK-së 2018 | | | | | | |
|---|-------------------------------|---------------------------|-------------------------|---------------------------|----------------------------|------------------------------|
| Kategoritë ekonomike | Buxheti fillestar 2018 | Buxheti Final 2018 | Buxheti i zotuar | Buxheti i zotuar % | Buxheti i shpenzuar | Buxheti i shpenzuar % |
| Sekretariati i KGJK-së | 2,721,586.00 | 2,553,308.16 | 2,439,590.54 | 95.55 | 2,397,270.43 | 93.89 |
| ZPD | 337,191.00 | 286,837.53 | 239,285.76 | 83.42 | 232,567.79 | 81.08 |
| NjShPGj | 109,493.00 | 123,347.06 | 108,581.91 | 88.03 | 106,897.08 | 86.66 |
| Gjykata Supreme dhe Dhoma Posaçme | 1,164,543.00 | 1,668,968.99 | 1,603,538.43 | 96.08 | 1,595,783.02 | 95.61 |
| Gjykata e Apelit | 1,438,246.00 | 2,065,782.62 | 2,001,771.57 | 96.90 | 1,992,079.67 | 96.43 |
| Gjykata Themelore Prishtinë | 4,633,592.00 | 6,021,462.17 | 5,931,591.30 | 98.51 | 5,913,266.52 | 98.20 |
| Gjykata Themelore Prizren | 2,330,561.00 | 2,853,297.88 | 2,796,307.90 | 98.00 | 2,790,404.89 | 97.80 |
| Gjykata Themelore Gjilan | 2,081,948.00 | 2,611,656.60 | 2,569,974.98 | 98.40 | 2,561,615.91 | 98.08 |

| | | | | | | |
|------------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------|--------------|----------------------|--------------|
| Gjykata Themelore Ferizaj | 1,679,921.00 | 2,082,099.27 | 2,047,607.14 | 98.34 | 2,047,414.14 | 98.33 |
| Gjykata Themelore Pejë | 2,242,664.00 | 2,689,536.95 | 2,610,828.64 | 97.07 | 2,588,094.93 | 96.23 |
| Gjykata Themelore Gjakovë | 1,609,917.00 | 2,010,251.48 | 1,822,635.77 | 90.67 | 1,805,343.19 | 89.81 |
| Gjykata Themelore Mitrovicë | 3,145,362.00 | 4,058,505.12 | 3,665,370.45 | 90.31 | 3,662,853.72 | 90.25 |
| Totali | 23,495,024.00 | 29,025,053.83 | 27,837,084.39 | 95.91 | 27,693,591.29 | 95.41 |

Siç shihet në tabelën e mësipërme, sipas programeve buxheti i KGjK-së është shpenzuar si në vijim:

Buxheti për programin e Sekretariatit të KGjK:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 95.55 %, ndërsa, është shpenzuar 93.89 %.

Buxheti për programin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 88.42%, ndërsa, është shpenzuar 81.08%.

Buxheti për programin e Njesisë për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 88.03 %, ndërsa, është shpenzuar 86.66%.

Buxheti për programin e Gjykatës Supreme dhe Dhomës së Posaçme:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 96.08 % ndërsa, është shpenzuar 95.61%.

Buxheti për programin e Gjykatës së Apelit Prishtinë:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 96.90 %, ndërsa, është shpenzuar 96.43%.

Buxheti për programin e Gj.Th Prishtinë:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.51 %, ndërsa, është shpenzuar 98.20%.

Buxheti për programin e Gj.Th Prizren:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.00 %, ndërsa, është shpenzuar 97.80%.

Buxheti për programin e Gj.Th Gjilan:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.40 % ndërsa është shpenzuar 98.08%.

Buxheti për programin e Gj.Th Ferizaj:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 98.34 %, ndërsa, është shpenzuar 98.33%.

Buxheti për programin e Gj.Th Pejë:


- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 97.07%, ndërsa, është shpenzuar 96.23%.

Buxheti për programin e Gj.Th Gjakovë:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 90.67 %, ndërsa, është shpenzuar 89.81%.

Buxheti për programin e Gj.Th Mitrovicë:

- Buxheti në total për të gjitha kategoritë ekonomike për këtë program është zotuar 90.31 %, ndërsa, është shpenzuar 90.25%.



DEPARTAMENTI I STATISTIKËS

- Raporti i përgjithshëm Statistikor për TREM I-rë 2018 është përfunduar në fund të muajit prill 2018;
- Raporti i përgjithshëm Statistikor për TREM II-të dhe GJASHTËMUJORIN I-rë 2018 është përfunduar në fund të muajit korrik 2018;
- Raporti i përgjithshëm Statistikor për TREM III-të dhe NËNTËMUJORIN e vitit 2018 është përfunduar në fund të muajit tetor 2018;
- Nga Komisioni për Vlerësimin e Përformancës së Gjyqtarëve kemi pas kërkesë për 78 gjyqtarë, pra janë kompletuar dosjet me te dhënat statistikore për 36 muaj;
- Raportet statistikore për Lëndët e Vjetra të gjykatave, TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportet statistikore për v.p. që kanë të bëjnë me Korrupsionin, TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportet e rregullta për Ministrin e Integritimit Evropian, TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportet e rregullta për Ministrin e Punëve të Brendshme për v.p. Trafikim me Njerëz, TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportet e rregullta për Ambasadën Amerikane për v.p. Trafikim me Njerëz, TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportimi i rregullt në “Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin” për TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportet statistikore për v.p. të kryera Agjencinë e Statistikave të Kosovës, TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportimi i rregullt në OSCE, për TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportimi i rregullt zyrtarëve të EULEX-it, për TREM I, TREM II, TREM III dhe TREM IV-të për vitin 2018;
- Raportimi i rregullt për të gjithë gazetaret e akredituar si dhe OJQ-ve të akredituara.

DEPARTAMENTI I LOGJISTIKËS

Në bazë të Rregullores nr.12/2015, të KGJK-së për organizimin e brendshëm të Sekretariatit, ekziston edhe Departamenti i Logjistikës si njësi e shërbimeve të përbashkëta është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të departamentit të logjistikës aktualisht punojnë nëntë (9) staf administrativ.

Ky departament gjatë vitit 2018 ka realizuar aktivitet si në vijim:

Investimet Kapitale

Në kuadër të realizimit të projekteve që janë përfshirë si investime kapitale janë si në vijim:

- Kontrata e punëve për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega në Graçanicë
- Kontrata e punëve ndërtimore për objektin e Gjykatës në Graçanicë është në realizim e sipër, punët janë duke vazhduar me dinamikën e paraparë dhe jemi në fazën finale të punimeve;
- Punët e realizuar janë rreth 85 % te gjitha punimeve;
- Pagesat e realizuar deri më tani janë 83 % te kontratës totale;
- Kontrata e Mbikëqyrjes së punëve për ndërtimin e objektit të Gjykatës në Graçanicë;
- Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore ka vazhduar sipas kontratë, gjithashtu, pagesat janë bërë sipas punëve të realizuara nga kompania ndërtimore. Kjo mbikëqyrje është duke realizuar në koordinim me kompaninë kontraktuese nga SGJK.

Projekti kryesor për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega Fushë Kosovë.

- Gjatë këtij viti është realizuar edhe projektin kryesor për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega Fushë Kosovë. Projekti është realizuar nga një kompani e jashtme nën mbikëqyrjen e departamentit të Logjistikës. Tani projekti është në Urbanizëm të Komunës së Fushë Kosovës për marrjen e Lejes Ndërtimore.

Punët e kryera të realizuar në vitin 2018 në kuadër të investimeve kapitale të cilat janë:

- “Kontrata për riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të gjykatave dhe SKGJK-së” Punët e realizuara në kuadër të kësaj kontrate në te gjitha objektet e gjykatave kapin vlerën e investimeve 165,696.58 €;
- “Ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega në Graçanicë” Punimet e realizuara kapin vlerën prej 309,975.93 €;

- “Mbikëqyrja e punëve për ndërtimin e objektit të Gjykatës në Graçanicë” Punimet e realizuara kapin vlerën prej 1,115.91 €;
- “Projekti kryesor për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore Prishtinë, dega Fushë Kosovë”. Vlera e investimit 14,000.00 €.

Ndër objektivat kryesore të Departamentit të Logjistikës gjatë vitit 2018, ka qenë investimet kapitale në realizimin e kërkesave nga ana e gjykatave për krijimin e kushteve sa më të mira për punë. Në kuadër të këtij objekti kemi pasur pengesa nga komuna e Prizrenit e cila nuk ka arritur të gjej lokacion për ndërtimin e Gjykatës dhe si rezultat, ne nuk kemi arritur të realizojmë projektin kryesor për objektin e kësaj Gjykate, e që mjetet e ndara për këtë projekt ishin me vlerë prej 30.000 €.

Po ashtu, kemi pasur vonesa edhe nga komuna e Fushë Kosovës për caktimin e lokacionin për ndërtimin e Gjykatës dhe nuk kemi arritur për vitin 2018 të fillojmë punimet, por kemi punuar vetëm projektin kryesor të objektit për këtë Gjykate, ndërsa punimet do të fillojnë këtë vit.

Shpenzimet e automjeteve janar-shtator 2018 (gjykatat dhe SKGJK)

Në këtë raport po e pasqyrojmë shkurtimisht gjendjen e shpenzimeve të automjeteve të KGjK-së dhe gjykatave vetëm për nëntë mujorin 2018, për shkak se për tre mujorin e fundit ende gjykatat nuk i kanë dorëzuar raportet në SKGJK.

Për shkak të vjetërsisë së automjeteve që kemi pasur në shfrytëzim, SKGJK ka larguar nga përdorimi gjithsej, 41 automjete të vjetra të cilat ka pasur shpenzime të larta në mirëmbajtje dhe harxhime të derivateve. Prej këtyre 41 automjeteve, 26 i janë dhënë MAP-it për shëtitje përmes ankandit publik dhe 15 automjete i janë transferuar Agjencisë së Pyjeve të Kosovës. Si rezultat i largimit të 41 automjeteve të vjetra nga përdorimi për kompozimin e tyre kemi marrë 41 automjete të reja me qira nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Prej këtyre 41 automjeteve me qira janë:

- 2 automjete janë të tipit Peugeot me vlerë e qirasë mujore prej 497.96 €;
- 16 automjetet të tipit Reno Megane me vlerën e qirasë mujore 347 €;
- 23 automjete të tipit Dacia Sandero me vlerë të qirasë mujore prej 247 €.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.03/2014 për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare, respektivisht nenit 13 pika 1, Udhëheqësi i Divizionit të Transportit ka hartuar raportin për shpenzimet e nëntëmujorit 2018 për të gjitha automjetet e KGjK-së dhe gjykatave.

Veturat e gjyqësorit për këtë nëntëmujor kanë kaluar gjithsej 1274420 km dhe kanë shpenzuar 95697 litra karburant.

Nga pasqyra e raportit rezulton se mesatarja e shpenzimeve të karburantit për 100 km është 7.5 litra. Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve për nëntëmujorin 2018 janë 33683 Euro.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (nëntëmujori 2017) tani kemi rritje të kilometrave të kaluara. Për shkak se ende nuk kanë arritur shpenzimet për tremujorin e fundit për automjete ky raport i automjeteve është bere vetëm për nëntëmujor.

Në tabelën në vijim janë dhënë shpenzimet të krahasuara për nëntëmujorin për vitet 2017 dhe 2018

| Nr. | Muaji/Viti | Km e përgjth. | Shpenz. e karburantit në litra | Shpenzimet e karburantit për 100/km | Shpenzi. e karbu. në Euro | Shpenzimet e mirëmb. Euro | Shërbi. Qirasë në Euro | Shpenzi. gjithsej në Euro |
|-----|------------------------------|---------------|--------------------------------|-------------------------------------|---------------------------|---------------------------|------------------------|---------------------------|
| 1. | Nëntëmujori 2017 | 1070437 | 92888 | 8.7 | 88589 | 54996 | 0 | 143585 |
| 2. | Nëntëmujori 2018 | 1274420 | 95697 | 7.5 | 102758 | 33683 | 105498 | 241939 |
| 3. | Diferenca | 203983 | 2809 | 1.2 | 14169 | 21313 | 105498 | 98354 |
| 4. | Shprehur në (%)raporti është | 19 % rritje | 3 % rritje | 13.79% zbritje | 16 % rritje | 39 % zbritje | 0 | 68.5 % rritje |

Bazuar në tabelën e më sipërme shihet se kemi rritje të harxhimit të karburanteve për automjete për 2809 litra, ose shprehur në përqindje 3 % për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Po ashtu, kemi rritje për kilometra te kaluara për 203983 km, ndërsa kemi zbritje të shpenzimeve në mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve për 39 %. Bazuar në këto të dhëna kemi rritje të shpenzimeve të përgjithshme të automjeteve zyrtare për 68.5 %. Gjatë nëntëmujorit 2018, KGJK dhe gjykatat kanë poseduar gjithsej 125 automjete, ku në tabelën e më sipërme janë dhënë shpenzimet e përgjithshme për te gjitha automjete.

Raportet e pranimit në Free Balance

Raportet e pranimit në Free Balance nga lëndët e prokurimit konsiderojmë se janë kryer në kohën e duhur nga Zyrtari i Logjistikës gjithnjë duke mos krijuar vonesa në kryerjen e obligimeve ndaj operatoreve ekonomik.

Furnizimi me material zyrtar, material të shtypur, kompjuter dhe pajisje të TI-së, shpenzimet e shërbimeve (rryma, uji, nxehjet qendrore).

Furnizimin me material zyrtar dhe material të shtypur jemi kujdes ta bëjmë sipas kërkesave dhe nevojave që janë shfaqë përgjatë vitit nga zyrtarët brenda SKGJK-së si dhe njësisve tjera si NJSHPGJ, ZVVGJ dhe ZPD.

Gjithsej, furnizimi me material zyrtar dhe material të shtypur për SKGJK-në dhe njësitë për vitin 2018 arrin vlerën totale prej 7599.46 €.

Po ashtu, gjatë vitit 2018 kemi bërë furnizim në të gjitha gjykatat sipas nevojës me kompjuter dhe pajise të TI-së dhe uniforma për gjyqtar. Në të gjitha gjykatat, kemi shpërndarë gjithsej, 335 uniforma për gjyqtar të niveleve të ndryshëm. Po ashtu, për gjykata gjatë vitit 2018 kemi shpërndarë gjithsej, 355 kompjuter.

Shpenzimet e shërbimeve si rryma, uji, nxehjet qendrore, telefonia fikse për SKGjK-në.

Gjatë këtij viti në objektin e KGjK-së shpenzimet e ujit, rrymës, ngrohjes qendrore, telefonisë fikse duke përfshirë edhe telefoninë mobile për krejt gjykatat kapinë vlerën prej 82.652,47 €.

Menaxhimi i kontratave, pjesëmarrja në komisione

Kontrata - Furnizim me inventar për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatat. Furnizimet e realizuara në kuadër të kësaj kontrate i kemi bërë në të gjitha gjykatat, ku shuma e tyre është me vlerë prej 81.072,00 €. Furnizimin me inventar e kemi bërë në bazë të kërkesave të gjykatave dhe janë realizuar të gjitha.

Kontrata – Servisimi i klimave, sistemit të klimatizimit dhe ventilimit në gjykata dhe SKGJK. Servisimet e realizuara në kuadër të kësaj kontrate i kemi bërë në të gjitha objektet e gjykatave, përjashtimisht Pallatit të Drejtësisë. Vlera e investimeve për realizimin e kësaj kontrate, gjatë vitit 2018 ka qenë në shumë prej 37.493,32 €.

Punët tjera të realizuara gjatë vitit 2018 nga Departamenti i Logjistikës janë:

- Përgatitja e detyrës projektuese për projektin e ideor të Gjykatës të Fushë Kosovë;
- Përgatitja e specifikave dhe para masës për riparim dhe mirëmbajtje të objekteve të gjykatave të Kosovës;
- Përgatitja e specifikave për servisimin e klimave dhe sistemit të klimatizimit për gjykata dhe SKGjK;
- Përgatitjen e specifikave për inventar të gjykatave;
- Përgatitjen e specifikave për servisimin e Ashensorëve;
- Përgatitjen e specifikave për servisimin e aparateve automatike për shuarjen e zjarreve;
- Përgatitjen e para masës së punëve për ndërtimin e trafostacionit elektrik për objektin e Gjykatës në Graçanicë.

E-pasuria në gjykatat themelore

Në gjykatat themelore, zyrtarët e logjistikës kanë filluar të përdorin sistemin elektronik të data bazës E-pasuria dhe të gjitha hyrje-daljet me furnizime të ndryshme brenda Gjykatës janë bërë përmes sistemit E-pasuria. Po ashtu, migrimi i të dhënave nga Inventarizimi i vitit 2017 janë bartë në sistem gjë që ka mundësuar që tash në fund të vitit 2018, të kemi një pasqyrë sa më reale të pasqyrave financiare respektivisht një pasqyrë sa më të saktë të asetëve të cilat i kanë në shfrytëzim gjykatat.

Është me rëndësi të potencohet, se mjetet buxhetore të planifikuara në projektet kapitale për vitin 2018, janë shpenzuar mbi 95 % me të cilat janë kryer punimet e nevojshme në objektet e gjykatave e të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të punës për gjyqtarë dhe staf administrativ. Në përgjithësi të gjitha shërbimet logjistike që kanë qenë të parapara të kryhen nga departamenti i logjistikës për vitin 2018, janë realizuar në nivel të kënaqshëm.



DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr. 12/2015, neni 12, për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të Njesis së Auditimit të Brendshëm, aktualisht punojnë katër (4) staf administrativ.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm në kuadër të SKGjK ka hartuar dhe dorëzuar:

- Planin Strategjik të auditimit të brendshëm për periudhën 2018-2020 dhe
- Planin Vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2018.

Në Planin vjetor janë përcaktuar detyrat e auditimit që do të kryhen në sistemet e identifikuar në vitin aktual të parapara në planin strategjik.

Aktivitetet e auditimit kalohen nëpër këto faza:

Planifikim, punë në teren, raportim dhe monitorim për zbatimin e rekomandimeve. Pas përpilimit të planit strategjik, dhe planit vjetor konsultimeve me menaxhmentin për vitin 2018, kemi planifikuar gjithsej shtatë (7) auditime të rregullta brenda kësaj periudhe.

Njësit që janë audituar gjatë vitit 2018 janë:

Gjykata Supreme - Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, gjykatat themelore, degët e gjykatave themelore dhe në këto objektiva të auditimit:

- Menaxhimin e shpenzimeve në Gjykata (me proceduar prokurimit në E-Prokurim);
- Menaxhimi i Depozitave Gjyqësore;
- Menaxhimi i Parave të Gatshme (imtetë);
- Menaxhimin e transportit dhe servisimin e automjeteve;
- Menaxhimi i procedurave rekrutuese dhe me kontrata të veçanta;
- Menaxhimi i pasurisë jo financiare;
- Njësia për Administratë dhe Personel;
- Njësia për Buxhet dhe Financa;
- Njësia për Logjistikë;
- Njësia për Prokurim.

Sipas planit vjetor të vitit 2018 kemi përfunduar shtatë (7) auditime:

Raporti i Auditimit / 009/2018 - Menaxhimi i Fondit të Parasë së imët në SKGjK dhe në gjykata:

- Departamenti për Buxhet dhe Financa në SKGjK;
- Gjykata Supreme;
- Gjykata Themelore Prishtinë;

- Gjykata Themelore Ferizaj;
- Gjykata Themelore Gjakovë.

Raporti i Auditim / 017/2018 - Menaxhimi i depozitave gjyqësore në SKGJK dhe gjykata:

- Departamentit për Buxhet dhe Financa në SKGJK;
- Gjykata Themelore Gjilan;
- Gjykata Themelore Pejë;
- Gjykata Themelore Prizren;
- Gjykata Themelore Prishtinë.

Raporti i Auditim 021/2018 - Menaxhimi i procedurave të rekrutimit në SKGJK dhe gjykata dhe kontratat për shërbime të veçanta:

- Departamenti për Administratë dhe Personel në SKGJK;
- Gjykata e Apelit;
- Gjykata Themelore në Prishtinë;
- Gjykata Themelore në Pejë;
- Gjykata Themelore në Ferizaj.

Raporti i Auditim /028/2018 - Menaxhimi i procedurave të Prokurimit në mallra, shërbime dhe punë në SKGJK dhe gjykata:

- Zyra e Prokurimit në SKGJK;
- Gjykata Themelore Prishtinë;
- Gjykata Themelore Gjilan;
- Gjykata Themelore Gjakovë;
- Gjykata Themelore Pejë.

Raporti i Auditim / 030/2018 - Menaxhimi i Transportit në SKGJK dhe gjykata:

- Departamenti i Logjistikës në SKGJK;
- Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme;
- Gjykata Themelore në Prishtinë me degë;
- Gjykata Themelore në Prizren me degë.

Raporti i Auditim / 031/2018 - Menaxhimi i pasurisë jo financiare në SKGJK dhe gjykata:

- Departamenti për Buxhet dhe Financa në SKGJK;
- Gjykata Apelit në Prishtinë;
- Gjykata Themelore Ferizaj;



- Gjykata Themelore Pejë.

Raporti i Auditim / 024/2018 - Monitorimi dhe përcjellja e Planit të Veprimit nëpër gjykata dhe SKGJK në këto objektiva:

- Menaxhimi i shpenzimeve postare në SKGJK dhe gjykata;
- Menaxhimi i shpenzimeve të gjeneratorëve dhe mirëmbajtja;
- Menaxhimi i listave të pagave të rregullta dhe jashtë orarit në gjykata.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacioni në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit. Është bërë raportimi te udhëheqësi më i lart KGJK-së, lidhur me punën e auditimit gjashtë (6) muajor dhe vjetor si dhe tek Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në Ministrin e Financave sipas ligjit në fuqi.

DAB, në vazhdimësi ka bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.



ZYRA PËR TEKNOLOGJI INFORMATIVE DHE KOMUNIKIM

Projekti i SMIL (Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve) është projekti kryesor në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, projekti me financimin kryesorë të MPJN ka filluar me zbatim tij nga Janari i vitit 2014 me Fazën Përgatitore, ndërsa Faza Kryesore e Projektit të SMIL ka filluar nga 1 Korriku 2015. Ndërsa, zbatimin e projektit dhe arritjen e objektivave dhe rezultateve të projektit e kanë marrë përsipër vet KGJK dhe KPK. Me çka synohet të rritet efikasiteti i punës së gjykatave dhe prokurorive, të shkurtohet kohëzgjatja e kryerjes së lëndëve dhe rritet llogaridhënia dhe transparenca në punë. Gjatë vitit 2018, projekti ka arritur me sukses të përmbyllë Fazën Kryesore të Projektit që ka përfunduar në 31 Dhjetor 2018.

Të arriturat kryesore të Projektit të SMIL-it janë si në vijim:

Përgatitja e infrastrukturës harduerike; Është ndërtuar Qendra bashkëkohore e të dhënave në objektin e pallatit të drejtësisë, e cila do ka kapacitete të mjaftueshme për pesë deri shtatë vitet e ardhshme. Janë rritur kapacitetet e rrjetave kompjuterike të gjykatave dhe prokurorive.

Zhvillimi i softuerit të SMIL; Zhvillimi i SMIL për gjykata, deri tani është zhvilluar SMIL për Lëmin Penale Për Departamentin e Përgjithshëm, Krimet të Rënda dhe Departamentin për të Mitur, për Lëmin Civile dhe për Lëmin e Kundërvajtjes.

Trajnimi i përdoruesve dhe vënia në zbatim e sistemit; Nga 15 Shkurti 2018, ka filluar faza e trajnimit dhe vënies në zbatim të sistemit për Lëmin Penale vetëm në 17 gjykata që janë në kuadër të pesë regjioneve: Ferizaj, Gjiilan, Prizren, Gjakovë dhe Pejë.

Të arriturat kryesore në pesë regjionet janë:

- Të gjitha lëndët Penale regjistrohen menjëherë në SMIL;
- Niveli i përdorimit të SMIL nga gjykatësit në muajin Nëntor 2018 ka qenë 95%. Kjo do të thotë se, gjykatësit gjatë muajit Nëntor 2018 në pesë regjionet cekura më lartë, përmes përdorimit të SMIL kanë zgjidhur 95% të lëndëve dhe vetëm 5% pa përdorimin e SMIL.

Arsyeja për mos fillimin e planit të trajnimeve për regjionin e Prishtinës dhe Mitrovicës ka qenë për shkak se projekti nuk ka pasur fonde për këtë komponentë. Gjatë vitit 2019, Projekti i SMIL do të zgjerojë trajnimet dhe vënien në zbatim të sistemit në të gjitha regjionet dhe të gjitha lëmit.

Përgatitja e bazës ligjore dhe rregullative; Për të ndërlidhur SMIL me sistemet elektronike të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Agjencisë së Bizneseve, KGJK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto


institucione me qëllim të shkëmbimit të të dhënave në formë elektronike. Gjithashtu, është aprovuar edhe rregullorja për shfrytëzimin e TIK-ut në sistemin gjyqësor.

Me rastin e përfundimit me sukses të Projektit të SMIL në të dy fazat paraprake të projektit, është arritur të sigurohen fonde nga donatori i projektit edhe për një fazë të re të quajtur "Faza Konsoliduese e Projektit të SMIL". Qëllimi i kësaj faze është për të përkrahur KGJK dhe KPK për një fazë tranzitore në krijimin e kapaciteteve për të marrë vetë përsipër vazhdimin e projektit pas kësaj periudhe. Kjo fazë do të zgjasë tre vite (2019 – 2021) dhe do të jetë e fokusuar në tre shtylla kryesore:

- Vazhdimi i ofrimit të trajnimeve dhe shërbimeve të përkrahjes për përdorues;
- Avancimi dhe përmirësimi i SMIL;
- Asistimi i KGJK dhe KPK për të ngritur kapacitetet për të marrë përsipër projektin.

Për fillimin e Fazës Konsoliduese të Projektit TIK/SMIL, në fund të vitit 2018 janë arritur marrëveshjet me rëndësi për zbatimin e projektit në mes institucioneve tona dhe donatorit si në vijim:

- Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Qeverisë së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Drejtësisë, KGJK, KPK dhe Ambasadës Norvegjeze, si dhe
- Marrëveshja e Grandit për Fazën Konsoliduese të Projektit të SMIL në mes KGJK dhe MPJN.



ZYRA E PROKURIMIT

Zyra e Prokurimit i ka kryer të gjitha aktivitetet e prokurimit në përputhshmëri të plotë me Planin e Prokurimit, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Neni 8, dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, neni 5, nga data 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2018, procedurat e prokurimit: punë/shërbime/ dhe furnizim për Këshillin Gjyqësor me Njësitë e saj dhe për të gjitha nivelet e gjykatave.

Të gjitha procedurat për kontratat janë zhvilluar komform me Ligjin e Prokurimit Publik, neni 6, ekonomiciteti dhe efikasiteti, dhe neni 7, barazia në trajtim / jo-diskriminimi, si dhe të gjitha dispozitat e tjera relevante ligjore.

Ka trajtuar të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe në mënyrë transparente, ka ndihmuar në procedurat e prokurimit për zyrtaret e prokurimit në gjykata kur është paraqitur nevoja për t'ju ndihmuar.

Zyra e Prokurimit ka nxjerrë urdhër blerjet për: punë/shërbime/ dhe furnizim për KGJK me njësitë e saj, dhe për të gjitha nivelet e gjykatave, ka bashkërenduar komisionet komform LPP-së, neni 58 dhe 59, anëtarët e komisionet për hapje dhe vlerësimin e ofertave.

Kjo Zyrë, është një ndër institucionet e para qendrore që ka përdorë platformën 'E-prokurimi', duke filluar me publikimin e njoftimit, hapjen e ofertave dhe vlerësimin e ofertave deri te shpallja e fituesit të kontratës. Në vazhdimësi ne kemi bashkëpunuar me institucionet siç janë: Komisioni i Rregullativ i Prokurimit Publik, (KRPP) dhe Autoriteti Qendror i Prokurimit (AQP).


Gjithashtu, kemi përgatitur Raportin e kontratave kublike, të nënshkruar nga data 1 janar deri me 31 dhjetor 2018, si në vijim: punë /shërbime/ dhe furnizim, për KGJK me njësitë e saj si dhe për të gjitha nivelet e gjykatave.

Gjithsejtë janë nënshkruar njëzet e nëntë (29) kontrata publike si në vijim:

- Mirëmbajtja e ngrohjes qendrore për objektin e Gjykatën Themelore Pejë dhe degët e saj - Kontratë Publike Kuotimi në vlerë prej: 4,139.15€;

- Furnizim me material të shtypur për të gjitha nivelet e gjykatave dhe KGjK-së me njësitë e saj - Kontrate Publike Kornize për 24 muaj, në vlerë prej: 222,092.80€;
- Blerja e Licemcave për Firewall - Palo Alto - Kontratë Publike Kuotimi në vlerë prej: 5,761.36€;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave dhe SKGjK-së - Kontratë Publike Kornize, për 36 muaj, në vlerë prej: 350,734.45 €;
- Blerja e aparateve të barkod dhe trakeve për barkode për të gjitha nivelet e gjykatave - Kontratë Publike Kuotimi, në vlerë prej: 3,620.00€;
- Transporti i kontejnerëve dhe gjeneratorëve nga objektet e gjykatave - Kontratë Publike me vlerë minimale prej: 980.00 €;
- Furnizim me ujë për zyrën e kryesuesit të KGjK-së dhe zyrën e drejtorit të SKGJK-së - Kontratë Publike në vlerë minimale një (1) vjeçare, në vlerë prej : 946.00€;
- Furnizim me Inventar për KGjK-në dhe të gjitha nivelet e gjykatave, Kontratë Publike Kornizë - për 36 muaj në vlerë prej: 216,485.00€;
- Punimi i tabelave me mbishkrim për objektin e Gjykatës Themelore Mitrovicë - Kontratë Publike me vlerë minimale prej: 440.00 €;
- Furnizim me uniforma për gjyqtarë/e - Kontratë Publike me vlerë të mesme prej: 16,660.00€;
- Servisimi i klimave, sistemit të klimatizimit dhe ventilimit në gjykata dhe SKGjK - Kontratë Publike Kornize, çmimi për njësi për 24 muaj, me vlerë të mesme prej: 7,978.52€;
- Furnizimi me klima për SKGjK dhe gjykata - Kontratë Publike Kuotimi, në vlerë prej: 8,030.00€;
- Shërbimet e Televizionit kabllorin dhe Internetin për KGjK - Kontratë Publike vlerë minimale prej: 592,82 €;
- Publikimi i pozitave të lira në mjetet e informimit publik - Kontratë Publike në vlerë minimale prej: 470.00 €;
- Sigurimi Fizik i personelit dhe objektit të SKGjK - Kontratë Publike Kuotimi, në vlerë minimale në prej: 6,044.40€;

- Servisimi dhe mirëmbajtja e sistemit të shuarjes automatike të zjarrit në objektet e gjykatave dhe SKGjK - Kontratë Publike Kuotimi, në vlerë prej: 9,937.00€;
- Mirëmbajtja e pajisjeve për TI-ve, për KGjK me njësitë e saj: SKGjK, ZPD, NJSHPGJ, ZVVGJ - Kontratë Publike Kuotimi, vlerë e mesme në vlerë prej: 4,183.00 €;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve në të gjitha nivelet e gjykatave dhe SKGjK - Kontratë Publike Kornize, çmimi për njësi për 24 muaj, me vlerë të mesme prej: 6,218.15€;
- Shërbimet e Bufes ne objektin e SKGjK - Kontratë Publike Kornizë, çmimi për njësi për 24 muaj, me vlerë të mesme në vlerë prej: 4,25 €;
- Punimi i projektit kryesor për objektin e Gjykatës Themelore Prishtinë, dega Fushë Kosovë - Kontrate Publike në vlerën mesme prej: 14,000.00€;
- Sigurimi i auto përgjegjësisë për automjetet e KGjK-së dhe njësite të saj - Kontratë Publike Kuotimi, në vlerë prej: 3,368.90 €;
- Pastrimi I veturave për: SKGjK, ZPD, NJSHPGJ - Kontratë Publike minimale, prej: 825.00 €.
- Blerja e notesëve, lapsave kimik, qese letre me llogo dhe ftesa - Kontratë Publike Kuotimi në vlerë prej: 1,525.00 €;
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të KGJK-së dhe njësite të saj - Kontratat Publike Kornizë, çmimi për njësi për 12 muaj, me vlerë të mesme në vlerë prej: 10,243.43 €;
- Blerja e sistemit për menaxhimin e shërbimeve të TIK të qendrës se thirrjeve për KGjK dhe gjykata, si dhe furnizim me licenca për fire all për 3 vite - Kontratat Publike, vlerë te mesme në vlerë prej: 59,770.87 €;
- Hosting të portalit gjyqësor - Kontratë Publike Kuotimi në vlerë prej: 1,100.00 €;
- Furnizim me Artefakte me përmbajtje të Kosovës për delegacionet të cilat vizitojnë KGjK-në - Kontratë Publike në vlerë minimale prej: 900.00€;
- Kontrollimi teknik i automjeteve të KGjK-së me njësite e saj - Kontratë Publike në vlerë minimale prej: 540.00€.



ZYRA PËR EVIDENCË PENALE

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, gjatë vitit 2018, ka vazhduar Aktivitetet në funksion të Ngritjes dhe Konsolidimit të Sistemit qendror të Evidencës Penale të Kosovës - SQEPK. (Regjistri Qendror i Evidencës Penale të personave të Dënuar).

Zyra e Evidencës Penale, pran Sekretariatit të KGJK-së, ka ndërmarrë një seri të aktiviteteve të cilat ishin të orientuara në drejtim të: Konsolidimit të Bazës Ligjore, Ngritjes së Data bazës Qendrore të Evidencës Penale, procesit të Digjitalizimit të Lëndëve të vjetra Penale, dhe ngritjes së kapaciteteve të brendshme të gjykatave për menaxhimin e këtij procesi.

Edhe këtë vite procesi i konsolidimit të SQEPK-së, u zhvillua në partneritet të ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë, e cila është duke e zhvilluar projektin tre (3) vjeçar të asistencës pran KGJK-së.

Gjatë këtij viti KGJK, në bashkëveprim me Projektin NCCR/BE filloj procesin masiv të Digjitalizimit të Lëndëve të vjetra penale (Lëndëve me Aktgjykime të Plotfuqishme) në gjykatat themelore të vendit dhe në degët e tyre, për qëllime të procesit të digjitalizimit u Rekrutuan gjithsej: 51 Konsulent ligjor të cilët janë shpërndarë nëpër të gjitha gjykatat e shkallës së parë në nivel vendi.

Procesi i digjitalizimit zyrtarisht ka nisur në muajin korrik 2018 dhe deri më datën 30/12/2018. Në Data bazën Qendrore të Evidencës Penale, janë evidentuar gjithsej: 76 349, raste (Persona të Dënuar).

Procesit të Digjitalizimit do t'i nënshtrohen të gjitha Lëndët Penale të Plotfuqishme të cilat i referohen periudhës kohore nga viti 1999 e tutje.

Po ashtu, gjatë këtij viti u punua edhe në konsolidimin e Bazës ligjore në funksion të funksionalizimit të SQEPK-së, për këtë qëllim KGJK, aprovoj Rregulloren e re mbi Sistemin Qendror të Evidencës Penale dhe aprovoj Planin implementues mbi krijimin dhe funksionalizimin e sistemit të evidencës penale.

Kjo zyrë gjatë kësaj periudhe ka kryer edhe këto aktivitete si në vijim:

- KGJK me datën 02/05/2018, aprovoj Rregulloren Nr. 01/2018, (KGJK.nr.24/2018) Mbi Sistemin Qendrorë të Evidencës Penale të Kosovës;
- KGJK me datën 30/11/2018, aprovoj Planin Implementues, mbi Krijimin dhe Funksionalizimin e Sistemit Qendror të Evidencës Penale të Kosovës, (Plani Implementues i Rregullores 01/2018);
- Janë në proces të hartimit, disa Akte nënligjore dhe Procedura standarde të Operimit, të cilat pritet të Aprovohen nga KGJK në periudhën vijuese;
- Nga Regjistrat Amë të gjykatave, janë nxjerrë Evidencat e sakta të Regjistrave dhe Lëndëve Penale të cilat do t'i nënshtrohen procesit të Digjitalizimit. Deri më datën 30/12/2018, në Data bazën Qendrore të Evidencës janë Regjistruar të dhënat për gjithsej: 76 349 persona të Dënuar;

- Gjatë këtij viti, është punuar me intensitet në ngritjen dhe konsolidimin e Data bazës Qendrore të Evidencës Penale, kjo Bazë e të dhënave është duke u ndërtuar duke marrë për bazë standardet e fundit të Teknologjisë informative dhe aspektet e sigurisë kibernetike;
- Zyra e Evidencës Penale, ka marrë pjesë aktivisht, në procesin e hartimit të Koncept Dokumentit, mbi Evidencën Qendrore Penale, ky proces është duke u udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë nën asistencën e Zyrës Kryeministrit të Kosovës;
- ZQEP, në koordinim me gjykatat, ka ndërmarrë një seri të aktiviteteve të cilat janë zhvilluar në drejtim të caktimit të kapaciteteve fillestare të gjykatave për menaxhimin e procesit, rrjedhimisht në pjesën më të madhe të gjykatave themelore dhe degëve përkatëse, janë caktuar zyrtarët kompetent (permanent) të Evidencës penale;
- ZQEP, ka filluar bashkëpunimin funksional me Departamentin për bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pran Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me shkëmbimin e të dhënave për personat e dënuar me shtetësi kosovare nga gjykatat e shteteve tjera;
- ZQEP, edhe këtë vit ka realizuar një bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante shtetërore, si MPB, Agjencinë e Regjistrimit Civil, Ministrin e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë etj, në funksion të realizimit të mandatit të saj;
- ZQEP, në koordinim me strukturat përkatëse në SKGJK dhe Projektin NCCR, ka menaxhuar Aspektet Administrative, teknike dhe logjistike të procesit.

Situata Aktuale e Data Bazës Qendrore të Evidencës Penale

(Në këtë gjendje nuk janë përfshirë të dhënat për Degët e Gjykatave, Nr. e Lëndëve të shqyrtuara dhe të dhëna tjera specifike statistike).

| | | | |
|-----------|---|--------------------------------|---------------|
| 1 | Nr. Total i Rasteve në Data Bazë | | 76 349 |
| 2 | Nr. i Regjistrave të Evidencës të Shqyrtuar | | 202 |
| 3. | Nr. Individual i rasteve në Gjykatat Themelore | Gjykata Themelore ne Prishtinë | 27 460 |
| | | Gjykata Themelore ne Prizren | 9977 |
| | | Gjykata Themelore ne Ferizaj | 6413 |
| | | Gjykata Themelore ne Pejë | 9368 |
| | | Gjykata Themelore në Gjiilan | 8335 |
| | | Gjykata Themelore Mitrovicë | 7493 |
| | | Gjykata Themelore Gjakovë | 8002 |
| 4 | Nr. i rasteve te pranuar nga DBJN/MD (Të dënuar nga Gjykatat e shteteve tjera). | | 17 |

Gjatë vitit 2019, KGJK planifikon të përmbyll disa prej aktiviteteve kryesore si:

- Të përfundoj në tersi procesin e Digjitalizimit të lëndëve të vjetra penale;
- Të përmbyll procesin e nxjerrjes së Akteve Nënligjore, të cilat rregullojnë aspektet specifike të funksionimit të SQEPK-së;
- Të përfundoj procesin e caktimit të kapaciteteve të rregullta të gjykatave, për të siguruar vazhdimësinë e Evidentimit të Lëndëve të reja penale;
- Të vazhdoj bashkëpunimin dhe koordinimin e ngushtë me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe partneret tjerë relevant, në funksion të fillimit të operacionalizimit të SQEPK-së.



INTEGRIMI EVROPIAN

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është një nga kontribuuesit kryesor dhe fundamental në procesin e Integrimit Evropian, e në veçanti në sektorin e sundimit të ligjit. Në kuadër të SKGJK-së gjatë vitit 2018 ka ofruar raportime të rregullta që janë kërkuar nga ana e Ministrisë së Integritimit Evropian për përmbushjen e Marrëveshjes së Stabilizim Associmit, Agjendës Evropiane, Rishikimin e Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), Raportim mbi zbatimin e Programit për Reforma ne Ekonomi , Asistencës Zhvillimore etj, konkretisht raportime të rregullta mbi zhvillimet në sistemin e drejtësisë si dhe propozime të masave afat shkurtër dhe afat-mesme për tre (3) vitet e ardhshme. Gjatë vitit 2018, zyrtarja për integritime evropiane, ka qenë e pjesë e një numri të madh të punëtorive dhe konferencave që janë organizuar nga Ministria e Integrimit Evropian në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, Komisionin Evropian dhe GIZ. Gjatë periudhës raportuese janë organizuar dhe mbështetur disa Misione Vlerësuese në bashkëpunim me Ministrin e Integrimit Evropian. Në kuadër të Misioneve Vlerësuese të TAIX për Rishikim Kolegjial në gjashtë (6) shtetet e Ballkanit Perëndimor mbi aftësinë e tyre për të trajtuar me sukses korrupsionin e nivelit të lartë, krimin e organizuar dhe pastrimin e parave që mbulon tërë procedurën penale nga hetimi deri në vendimet përfundimtare, është realizuar Misioni Vlerësues i Sistemit të Drejtësisë. Po ashtu, gjatë vitit 2018 janë realizuar edhe tre (3) Misione tjera vlerësuese , Misioni Vlerësues për zbatimin e vendimeve gjyqësore civile përfshirë këtu edhe vendimet komerciale, Misioni Vlerësues kundërt terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe Misioni Vlerësues për rishikimin e lirisë së shprehjes, aktualisht janë pranuar raportet e ekspertëve lidhur me të gjeturat e Misioneve Vlerësuese të cilat janë duke u analizuar dhe komentuar nga ana e gjyqësorit.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe mbështetja e donatorëve

Gjatë vitit 2018, kemi marrë pjesë edhe në përpilimin e formës së përbashkët identifikuese për veprimin e IPA II- 2019-2020 në fushën e gjyqësorit.

Sa i përket mbështetjes së donatorëve, zyrtarja për Integritime Evropiane është anëtare e Shtyllës së V- Koordinimi ndër-institucional dhe bashkëpunimi me partnerët e zhvillimit në kuadër të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit ku ka dhënë kontributin në përpilimin e draft analizës sa i përket këtij sektori.

Bashkëpunimi me Projekte

SKGJK-ja ka pasur përkrahje të vazhdueshme nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe projektet sikundër është edhe Projekti i Binjakëzimit të BE-së "Fuqizimi i efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës së sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë". Gjithashtu, kemi ndihmuar projektin që t'i organizojë trajnime dhe punëtori me anëtarët e Këshillit, kryetarët e gjykatave dhe stafin e SKGJK-së. Kemi marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara të projektit dhe në plotësimin e rekomandimeve të ekspertëve për secilin aktivitet si dhe i kemi koordinuar takimet e përbashkëta që projekti i ka pasur me KGJK dhe KPK.

Jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm me Projektin e financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë për krijimin e Sistemit Kombëtar Qendror të Evidencës Penale (NCCR) në Kosovë, ku kemi qenë edhe pjesëmarrës në vizitën studimore të organizuar nga projekti NCCR për tu njoftuar nga afër rreth funksionimit të sistemit ECRIS në Evropë.

Gjithashtu, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar bashkëpunimi me Projektin SMIL, përmes raportimeve të rregullta që janë bërë në takimet me donator në kuadër të MIE mbi implementimin e projektit në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Një tjetër aktivitet që vlen të përmendim është edhe pjesëmarrja dhe organizimi i takimeve me Bordin Bashkërendues për Sundimin e Ligjit në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrin e Drejtësisë, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Zyrën e Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë.

Gjithashtu, edhe gjatë këtij viti ka vazhduar bashkëpunimin me projektin e USAID-it, (PFSD) me punëtori e trajnime të ndryshme.

ZYRA E PËRKTHIMEVE


Zyra për Mbështetje dhe Përkthime sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr.12/2015 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të Zyrës për Mbështetje dhe Përkthime aktualisht punojnë katër (4) punëtorë staf administrativ.

Zyra për përkthime në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK) gjatë vitit 2018, ka përkthyer të gjitha materialet që ka pranuar për përkthim si vendime, akte normative, rregullore, udhëzime, agjenda, njoftime, komunikata për media, raporte të ndryshme të njëjësive brenda SKGJK, si dhe raportet e NJSHPGj-së.

Është ofruar edhe përkthim simultan dhe konsektiv në të gjitha takimet e KGJK dhe Komisionet e tij, si dhe në komisionet intervistuese për gjyqtarë sa herë që është kërkuar. Vlen të theksohet, se në vazhdimësi kemi mbështetur Këshillin në përkthimin e të gjitha materialeve dhe incizimin e takimeve.

Kjo Zyrë, ka shërbyer edhe si anëtare e rrjetit dhe e bordit për shërbime gjuhësore në kuadër të Zyrës së Komisionarit për gjuhë. Gjatë vitit kemi pranuar disa ankesa për gjykata për mosrespektimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe kemi mbajtur disa takime. Fatmirësisht ne gjithmonë kemi hasur në mirëkuptim nga ana e gjykatave dhe kemi arritur që t'i zgjedhim ankesat e qytetarëve duke iu ofruar aktgjykimet edhe në gjuhën e tyre amtare.

Gjithashtu, kjo zyre përmes operatorit teknik ka mirëmbajtur pajisjet dhe ka siguruar ruajtjen e procesverbaleve, vendimet dhe të gjitha aktet që nxirren nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës mënyrë elektronike.



KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2018, Zyra për Informim Publik e SKGjK-së, mbështetur në parimin e të informuarit sa më të mirë, ka pasur mjaft aktivitete të cilat rezultuan me transparencë dhe bashkëpunim të ndërsjellë, si ndërmjet medias së shkruar dhe vizuale, ashtu edhe me organizatat jo qeveritare (OJQ).

Përveç kërkesave të vazhdueshme të mediave të shkruara dhe vizuale, Zyra për Informim publik e SKGjK-së, iu ka përgjigjur me korrektësi të gjitha OJQ-ve që punojnë dhe veprojnë në Kosovë, të cilat kanë monitoruar punën e gjyqësorit, në veçanti punën e gjykatave.

Të gjitha aktivitetet e kryesuesit kjo zyrë i mbështet në vazhdimësi, duke përpiluar, ftesa, njoftime, sqarime, reagime, komunikata, për këtë vit janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqe, fb dhe media.

Bazuar në monitorimin ditor të mediave nxjerrë statistikat e numrit të informatave me tema të ndryshme të publikuara në të gjitha mediat e ku përmendet sistemi gjyqësor. Kjo zyrë mbështet, organizon dhe përcjellë të gjitha e delegacionet vendore dhe ndërkombëtare që vizitojnë Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Jemi në përfundim të ridizajnit të ueb faqes zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave, të mbështetur nga projekti I USAID, JSSP.

Ne kemi mbështetur të gjitha organizatat joqeveritare, duke filluar nga Lëvizja Fol, BIRN, ATRC, Jeta, IKD, KDI, etj, ku ka qenë prezentë në të gjitha tryezat të cilat i kanë organizuar këto organizata.

Konferenca vjetore

Si aktivitet që e specifikon këtë zyrë, është edhe Konferenca Vjetore Gjyqësore e mbështetur, organizuar dhe moderuar nga kjo zyrë në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë. Kjo ishte Konferenca e tetë (8) vjetore e gjyqësorit, e cila është cilësuar si më e suksesshme ndër vite.

Temë kryesore në konferencën vjetore të këtij viti ishte: **‘Për një gjyqësor të pavarur, efikas, transparent dhe llogaridhënës’**.

Gjithashtu, në këtë konferencë janë bërë prezantime edhe nga shoqëria civile, Avokati i Popullit dhe Forumi i grave gjyqtare dhe prokurore të Kosovës.

Mbështetja e projekteve me ndërkombëtare

Kjo zyrë e ka mbështetur takimin e Bordit Bashkërendues për Sundimin e Ligjit që është organizuar nga KGjK, duke marrë pjesë në takim si dhe në përpilimin e përbashkët të komunikatës, dhe akoma është duke vazhduar bashkëpunimin me institucionet tjera lidhur me këtë Bord.

Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2018 kemi vazhduar bashkëpunimin me projektin e USAID-it, (JSSP), ka marrë pjesë në grupin punues për krijim e ueb faqes së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatave. Pastaj në të gjitha punëtorit e trajnimet të ndryshme në fushën e informimit publik si dhe me të gjitha organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare e që kanë të bëjnë me sistemin gjyqësor është pjesëmarrëse dhe kontribuuese e të gjitha këtyre takimeve.



ÇERTIFIKUESI

Zyrtari Certifikues, është përgjegjës që të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës. Të sigurojë që shpenzimi i parave publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me Rregullat e KMF, si dhe ushtron të gjitha detyrat të cilat i janë caktuar atij/asaj sipas Rregullave KMF (kontrollimi dhe menaxhimi financave).

Aktivitetet Kryesore

- Pranimi i lëndëve nga zyra e financave;
- Regjistrimi i lëndëve;
- Shqyrtimi i lëndëve;
- Shqyrtimi i shume kërkesave;
- Aprovimin e lëndëve në SIMFK;
- Menaxhimin i punëve administrative;
- Skanimi dhe ruajtja në formë elektronike e të gjitha lëndëve të procedura në sistemin FreeBalance (SIMFK);
- Raportimi tek menaxhmenti i lart ZKA-ja mbi ecurinë e punëve, si dhe dorëzimin e lëndëve në arkiv.

Të arriturat

Gjatë këtij viti në zyrën e certifikuesit janë pranuar gjithsejtë: 1482 lëndë për aprovimin dhe të gjitha lëndët e pranuar nga Departamenti i Financave janë aprovuar, lëndët kanë qenë në kategori të ndryshme ekonomike:

- Shpenzime Komunale;
- Subvencione dhe Transfere;
- Mallra dhe shërbime;
- Shpenzime Kapitale.